



## **BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

---

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1 pika 6 të Ligjit për Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15 dhe 06/16), dhe në lidhje me nenin 45 paragrafi 1 të Ligjit për Qarkullim Pagesor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 113/07, 22/08, 159/08, 133/09, 145/10, 35/11, 11/12, 59 / 12, 166/12, 170/13, 153/15 dhe 199/15), Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

### **V E N D I M**

#### **për kriteret dhe standardet për funksionimin e sistemeve të pagesave**

**("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 17/16)**

#### **I. Dispozitat e përgjithshme**

1. Ky vendim përcakton kriteret për klasifikimin e sistemeve të pagesave sipas rëndësisë së tyre në sistemin e pagesave të Republikës së Maqedonisë dhe standardet që duhet të përmbushin për punën e tyre efikase, të sigurt dhe të pandërprerë.

#### **II. Klasifikimi dhe kriteret**

2. Sistemet e pagesave klasifikohen në kategoritë e mëposhtme:
- sisteme të pagesave sistemikisht të rëndësishme (në tekstin e mëtejshëm SPSR);
  - sisteme të rëndësishme të pagesave (në tekstin e mëtejshëm: SRP) dhe
  - sisteme të tjera pagesave të (në tekstin e mëtejshëm: STP).

Sistemi i shlyerjes së Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore) klasifikohet si SPSR.

3. Banka Popullore kryen klasifikimin e sistemeve individual të pagesave në bazë të kriterëve të mëposhtme:

- ndikimin financiar nëpërmjet vlerës mesatare ditore të transaksioneve të pagesave të kryera nëpërmjet sistemit individual të pagesave gjatë vitit kalendarik paraprak;
- depërtimi i tregut nëpërmjet pjesëmarrjes në treg i numrit të transaksioneve të pagesave të sistemit të pagesave në raport me numrin e përgjithshëm të transaksioneve të pagesave të kryera nga të gjitha sistemet e pagesave të të njëjtit lloj gjatë vitit kalendarik paraprak, të shprehur në përqindje; dhe
- shlyerjen e sistemeve të tjera të pagesave ose sistemeve të shlyerjes së letrave me vlerë në sistemin individual të pagesave.

Sistemi i pagesave do të klasifikohet si SPSR nëse plotësohen të paktën dy nga kushtet e mëposhtme:

- vlera mesatare ditore e transaksioneve të pagesave tejkalon 90 miliard denarë;
- pjesëmarrja në treg e numrit të transaksioneve të pagesave në sistemin individual të pagesave është më i madh ose i barabartë me 75%, dhe/ose
- sistemet e tjera të pagesave ose sistemet e shlyerjes së letrave me vlerë kryejn shlyerjen në sistemin individual të pagesave.

Një sistem pagese që nuk është SPSR klasifikohet si STP nëse pjesëmarrja në treg e numrit të transaksioneve të pagesave të përpunuara nëpërmjet tij është më e madhe ose e barabartë me 25%. Përndryshe, sistemi i pagesave klasifikohet në STP.

Në rastin kur sistemi i pagesave plotëson njërin nga dy kushtet e përcaktuara në paragrafin 2, alinenë 1 dhe 2 të kësaj pike, ajo duhet të jetë në përputhje me principin numër 7, kërkesa kryesore 3, e theksuar në Tabelën 2.

### **III. Standardet për funksionimin e sistemeve të pagesave**

4. Standardet për funksionimin e sistemeve të pagesave në Republikën e Maqedonisë janë në përputhje me Principet e infrastrukturës së tregjeve financiare (në tekstin e mëtejshëm: Principe) të Komitetit për Sistemet e Pagesave dhe të Shlyerjes së Bankës për Shlyerje Ndërkombëtare dhe Bordit të Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve për letrat me vlerë të cilat kanë të bëjnë me sistemet e pagesave. Principet për funksionimin e sistemeve të pagesave janë si më poshtë:

#### 4.1. Principi 1: Baza ligjore

Sistemi i pagesave duhet të ketë një bazë ligjore të vendosur mirë, të qartë, transparente dhe të zbatueshme për çdo aspekt material të aktiviteteve të tij në të gjitha kompetencat përkatëse.

#### 4.2. Principi 2: Menaxhimi

Sistemi i pagesave duhet të ketë aranzhime të qarta dhe transparente të menaxhimit që promovojnë sigurinë dhe efikasitetin e sistemit të pagesave dhe mbështesin stabilitetin e sistemit më të gjërë financiar, objektivat e tjera relevante me interes publik dhe objektivat e palëve të prekura.

#### 4.3. Principi 3: Kornizë për menaxhim gjithëpërfshirës me rreziqet

Sistemi i pagesave duhet të ketë një kornizë të qëndrueshme për menaxhimin gjithëpërfshirës me rreziqet ligjore, të kreditit, të likuiditetit, operative dhe të tjera.

#### 4.4. Principi 4: Rreziku i kredisë

Sistemi i pagesave duhet në mënyrë efektive të masë, të monitorojë dhe të menaxhojë me ekspozimin e kredisë ndaj pjesëmarrësve dhe ekspozimet që rrjedhin prej proceseve të pagesave, kliringut dhe shlyerjes së tyre. Sistemi i pagesave duhet të mbajë fonde financiare të mjaftueshme për të mbuluar ekspozimin e tij të kredisë ndaj secilit pjesëmarrës në tërësi me një shkallë të lartë besimi.

#### 4.5. Principi 5: Siguria

Sistemi i pagesave që kërkon siguri për të menaxhuar ekspozimin e saj të kredisë ose ekspozimin kreditor të pjesëmarrësve të tij duhet të pranojë siguri me rrezik të ulët të kredisë, likuiditetit dhe tregut. Sistemi i pagesave gjithashtu duhet të vendosë dhe zbatojë koeficientët të rreptë adekuat të mbulimit dhe limite të përqendrimit.

4.6. Principi 7: Rreziku i likuiditetit Sistemi i pagesave duhet në mënyrë efektive të masë, të monitorojë dhe të menaxhojë me rrezikun e tij të likuiditetit. Sistemi i pagesave duhet të mbajë burime të mjaftueshme likuide të të gjitha valutat përkatëse për të përfunduar shlyerjen e detyrimeve të pagesave në të njëjtën ditë dhe, sipas rastit, shlyerje brenda ditës si dhe disa ditësh me një shkallë të lartë të besimit në një shtrirje të gjerë të stress-skenarëve të mundshëm që duhet të përfshijnë (por të mos kufizohen me atë) pamundësinë për të shlyer detyrimet e pjesëmarrësit dhe bashkëpunëtorët e tij që do të krijojnë detyrimin e përgjithshëm më të madhen të likuiditetit për sistemin e pagesave në kushte ekstreme, por të mundshme të tregut.

4.7. Principi 8: Përfundim i shlyerjes Sistemi i pagesave duhet të sigurojë një shlyerje të qartë dhe të sigurt përfundimtare të paktën deri në fund të ditës së valutës. Aty ku është e nevojshme apo e dëshiruar, sistemi i pagesave duhet të sigurojë shlyerjen përfundimtare gjatë ditës ose në kohë reale.

#### 4.8. Principi 9: Shlyerje me para të gatshme

Sistemi i pagesave duhet të kryejë shlyerjen e saj me para të gatshme në bankën qendrore me para aty ku është praktike dhe e mundur. Nëse nuk përdoren para në sistemin e pagesave të bankës qendrore, sistemi i pagesave duhet të minimizoj dhe në mënyrë rigorozë të kontrolloj rrezikun e kredisë dhe likuiditetit që rrjedh nga përdorimi i parave të gatshme në bankat komerciale.

4.9. Principi 12: Sistemet e shlyerjes të cilat përfshijnë shkëmbimin e vlerave Nëse sistemi i pagesave shlyen transaksionet të cilat përfshijnë shlyerjen e dy detyrimeve të lidhura (për shembull, letrave me vlerë ose transaksioneve të këmbimit valutor), atëherë duhet të tërhiqet rreziku i shumës kryesore duke kushtëzuar shlyerjen përfundimtare të një detyrimi me shlyerjen përfundimtare të detyrimit të tjetër.

#### 4.10. Principi 13: Rregullat dhe procedurat në rast të pamundësi për shlyerje të detyrimeve të pjesëmarrësit

Sistemi i pagesave duhet të ketë rregulla efektive dhe të përcaktuara qartë dhe procedura të menaxhimit në rast të pamundësisë për të shlyer detyrimet e pjesëmarrësit në sistemin e pagesave. Këto rregulla dhe procedura duhet të sigurojnë se sistemi i pagesave mund të ndërmarrë veprime në kohë për të kontrolluar humbjet dhe presionet e likuiditetit dhe të vazhdojë të përmbushë detyrimet e tij.

#### 4.11. Principi 15: Rreziku i përgjithshëm i biznesit

Sistemi i pagesave duhet të identifikojë, monitorojë dhe menaxhojë rrezikun e përgjithshëm të biznesit dhe të ketë neto-mjete të mjaftueshme likuide që rrjedhin nga kapitali për të mbuluar humbjet e përgjithshme potenciale të

biznesit, në mënyrë që të mund të vazhdojë me veprimtaritë dhe shërbimet e tyre nëse ata humbje realizohen. Më tej, neto-mjetet likuide duhet të jenë vazhdimisht të mjaftueshme për të siguruar rikuperimin ose ndërprerjen e rregullt të operacioneve dhe shërbimeve kritike.

4.12. Principi 16: Rreziku i kujdestarit të pronës dhe rreziku i investimeve  
Sistemi i pagesave duhet të mbrojë fondet e veta dhe të pjesëmarrësve të tij dhe të minimizojë rrezikun e humbjes dhe vonesës në qasjen në këto fonde. Investimet e sistemit të pagesave duhet të jenë në instrumente me rrezik minimal të kreditit, të tregut dhe të likuiditetit.

4.13. Principi 17: Rreziku operacional  
Sistemi i pagesave duhet të përcaktojë në mënyrë të besueshme burimet e e brendshëm dhe të jashtëm të rrezikut operacional dhe të zbusë ndikimin e tyre nëpërmjet përdorimit të sistemeve, politikave, procedurave dhe kontroleve të përshtatshme. Sistemet duhet të sigurojnë një nivel të lartë të sigurisë dhe besueshmërisë operationale dhe duhet të kenë një kapacitet adekuat dhe të përshtatshëm. Gjatë menaxhimit e vazhdimësisë së punës, duhet përpjekje për rikuperimi në kohë të operacioneve dhe përmbushje të detyrimeve të sistemit të pagesave në rast të një shtrirje të gjerë ndërprerjesh ose prishjeve të mëdha.

4.14. Principi 18: Kërkesat për qasje dhe pjesëmarrje  
Sistemi i pagesave duhet të ketë objektive dhe kriteret të zbuluara publikisht për pjesëmarrje, të cilat bazohen në risk dhe mundësojnë qasje të drejtë dhe të hapur.

4.15. Principi 19: Marrëveshjet e pjesëmarrjes me shumë nivele  
Sistemi i pagesave duhet të përcaktojë, monitorojë dhe menaxhojë rreziqet materiale ndaj të cilave ajo është e ekspozuar, dhe që rrjedh nga marrëveshjet për pjesëmarrje me shumë nivele.

4.16. Principi 21: Efikasiteti dhe efektiviteti  
Sistemi i pagesave duhet të jetë efikas dhe efektiv përballë kërkesave të pjesëmarrësve të tij dhe të tregjeve në të cilat operon.

4.17. Principi 22: Procedurat dhe standardet e komunikimit  
Sistemi i pagesave duhet të përdorë ose të paktën të përshtatet me procedurat dhe standardet përkatëse të komunikimit të pranuar ndërkombëtarisht, me qëllim që të lehtësohet efikasiteti në pagesë, kliring, shlyerje dhe regjistrim.

4.18. Principi 23: Shpalosja e rregullave, procedurave kryesore dhe të dhënave të tregut  
Sistemi i pagesave duhet të ketë rregulla dhe procedura të qarta dhe gjithëpërfshirëse dhe duhet të sigurojë informata të mjaftueshme që do t'u mundësojnë pjesëmarrësve të kenë një kuptim të saktë të rreziqeve, tarifave dhe kostove të tjera materiale ndaj të cilave ato ekspozohen kur marrin pjesë në të. Të gjitha rregullat relevante dhe procedurat kryesore duhet të bëhen publike.

5. Sistemet e pagesave në kategorinë SPSR, SRP dhe STP në veprimtarinë e tyre detyrimisht duhet të harmonizohen me principet në Tabelën 1 të kësaj pike sipas kategorisë në të cilat ato klasifikohen, teksti i plotë i së cilës është specifikuar në

pikën 4 të këtij vendimi dhe detyrimisht të harmonizohen me kërkesat kryesore përkatëse të specifikuara në Tabelën 2 të kësaj pike.

**Tabela 1. Principe të aplikueshme për sistemet e pagesave**

Principe	SPSR	SRP	STP
<i>Numri i përgjithshëm i principeve të cilat aplikohen</i>	<b>18</b>	<b>13</b>	<b>9</b>
Principi 1: Baza ligjore	X	X	X
Principi 2: Menaxhimi	X	X	X
Principi 3: Kornizë për menaxhim gjithëpërfshirës me rreziqet	X	X	X
Principi 4: Rreziku i kredisë	X		
Principi 5: Siguria	X		
Principi 7: Rreziku i likuiditetit	X	X*	
Principi 8: Përfundim i shlyerjes	X	X	X
Principi 9: Shlyerje me para të gatshme	X	X	
Principi 12: Sistemet e shlyerjes që përfshijnë shkëmbimin e vlerave	X		
Principi 13: Rregullat dhe procedurat në rast të pamundësisë për shlyerje të detyrimeve të pjesëmarrësit	X	X	X
Principi 15: Rreziku i përgjithshëm i biznesit	X	X	
Principi 16: Rreziku i kujdestarit të pronës dhe rreziku i investimeve	X		
Principi 17: Rreziku operacional	X	X	X
Principi 18: Kërkesat për qasje dhe pjesëmarrje	X	X	X
Principi 19: Marrëveshjet e pjesëmarrjes me shumë nivele	X		
Principi 21: Efikasiteti dhe efektiviteti	X	X	X
Principi 22: Procedurat dhe standardet e komunikimit	X	X	
Principi 23: Shpalosja e rregullave, procedurave kryesore dhe të dhënave të tregut	X	X	X

\* Në pajtim me pikën 3 paragrafi 4 të këtij vendimi.

**Tabela 2. Kërkesat kryesore të principeve që duhet të përmbushen nga sistemet e pagesave**

KK nr.	Kërkesa kryesor (KK)	SPSR	SRP	STP
	<b>Principi 1: Baza ligjore</b>	<b>5 KK</b>	<b>5 KK</b>	<b>5 KK</b>
1	Baza ligjore duhet të sigurojë një shkallë të lartë sigurie për çdo aspekt material të aktiviteteve të sistemit të pagesave në të gjitha kompetencat përkatëse.	X	X	X
2	Sistemi i pagesave duhet të ketë rregulla, procedura dhe marrëveshje që janë të qarta, të kuptueshme dhe në përputhje me ligjet dhe rregulloret relevante.	X	X	X
3	Sistemi i pagesave duhet të sigurojë që baza e saj ligjore për aktivitetet e saj të jetë e qartë dhe e kuptueshme për autoritetet kompetente, pjesëmarrësit dhe, aty ku është e rëndësishme, për klientët e pjesëmarrësve.	X	X	X

4	Sistemi i pagesave duhet të ketë rregulla, procedura dhe marrëveshje që janë të zbatueshme në të gjitha kompetencat përkatëse. Duhet të ketë shkallë të lartë sigurie se veprimet e ndërmarra prej tij në përputhje me rregulla dhe procedura e këtilla nuk do të anulohen, ndryshohen ose nuk do të jenë subjekt i pritjes.	X	X	X
5	Një sistem pagese që vepron nën kompetenca të ndryshme duhet të identifikojë dhe zbusi rreziqet që dalin nga çdo konflikt i mundshëm i ligjeve në kompetenca të ndryshme.	X	X	X
<b>Principi 2: Menaxhimi</b>		<b>7 KK</b>	<b>2 KK</b>	<b>1 KK</b>
1	Sistemi i pagesave duhet të ketë objektivë që i japin prioritet të lartë sigurisë dhe efikasitetit të tij dhe të cilat në mënyrë eksplicite mbështesin stabilitetin e sistemit financiar më të gjerë dhe objektivat e tjera relevante të interesit publik.	X		
2	Sistemi i pagesave duhet të ketë marrëveshje të dokumentuara të menaxhimit të cilat ofrojnë linja të qarta dhe të drejtpërdrejta të përgjegjësisë dhe llogaridhënies. Këto marrëveshje duhet të zbulohen dhe të vihen në dispozicion të pronarëve, autoriteteve kompetente, pjesëmarrësve dhe publikut më të gjerë.	X	X	X
3	Rolet dhe përgjegjësitë e bordit të drejtorëve (ose ekuivalent) të sistemit të pagesave duhet qartë të përcaktohen dhe duhet të dokumentohen procedurat për funksionimin e tij, duke përfshirë procedurat për përcaktimin, trajtimin dhe menaxhimin e konfliktit të interesave të anëtarëve të bordit. Bordi duhet të shqyrtojë punën e tij të përgjithshme dhe ushtrimin e anëtarëve individual të bordit në bazë të rregullt.	X		
4	Bordi përbërjen e tij duhet të ketë anëtarë të duhur me aftësi dhe inkurajime të përshtatshme për të përmbushur rolet e tyre. Kjo zakonisht kërkon përfshirjen e një anëtari (anëtarëve) joekzekutiv të bordit.	X		
5	Rolet dhe përgjegjësitë e menaxhmentit duhet të përcaktohen qartë. Menaxhmenti i sistemit të pagesave duhet të ketë përvojën e duhur, aftësi të llojllojshme dhe integritetin e nevojshëm për të përmbushur përgjegjësitë e tij për punë dhe menaxhimin e rrezikut të sistemit të pagesave.	X		
6	Bordi duhet të vendosi një kornizë të qartë dhe të dokumentuar të menaxhimit të rrezikut që përfshin politikën e sistemit të pagesave për tolerancën e rrezikut, caktimin e përgjegjësisë dhe raport mbi vendimet e rrezikut dhe përcaktimin se kush merr vendime në krizë dhe situata të jashtëzakonshme. Marrëveshjet e menaxhimit duhet të sigurojnë që administrimi i rrezikut dhe funksionet e kontrollit të brendshëm të kenë kompetenca, pavarësi, burime të mjaftueshme si dhe qasje në bord.	X		

7	Bordi duhet të sigurojë që vendosja, rregullat, strategjia e përgjithshme dhe vendimet kryesore të sistemit të pagesave të reflektojnë në mënyrë adekuate interesat legjitime të pjesëmarrësve të saj të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë dhe palëve të tjerë të përfëshira relevante. Vendimet e mëdha duhet t'u zbulohen qartësisht palëve të përfëshira dhe aty ku ato kanë një ndikim të gjerë tregu, ato duhet të jenë në dispozicion të publikut.	X	X	
	<b>Principi 3: Kornizë për menaxhim gjithëpërfëshirës me rreziqet</b>	<b>4 KK</b>	<b>1 KK</b>	<b>1 KK</b>
1	Sistemi i pagesave duhet të ketë politika, procedura dhe sisteme për menaxhimin e rrezikut me të cilin mundësohet përcaktimi, matja, monitorimi dhe menaxhimi i një sërë rreziqesh të cilat paraqiten në sistemin e pagesave ose janë në përgjegjshmëri të tij. Kornizat e menaxhimit të rrezikut duhet t'u nënshtrihen auditimeve periodike.	X	X	X
2	Sistemi i pagesave duhet të ofrojë stimuj për pjesëmarrësit, dhe aty ku është relevante edhe për klientët e pjesëmarrësve, për të menaxhuar dhe të parandaluar përhapjen e rreziqeve që ato e ekspozojnë.	X		
3	Sistemi i pagesave duhet të shqyrtojë rregullisht rreziqet materiale që ai merr përsipër nga subjektet e tjera dhe i shkakton ato tek subjektet e tjera (siç janë: sistemet e tjera të pagesave, bankat për shlyerje, ofruesit e likuiditetit dhe ofruesit e shërbimeve) si rezultat i ndërvarësisë dhe dhe të zhvilloj mjete të përshtatshme të menaxhimit të rrezikut për të trajtuar këto rreziqe.	X		
4	Sistemi i pagesave duhet të identifikojë skenarët që potencialisht mund ta parandalojnë atë të siguroj operacionet dhe shërbimet kritike, si dhe vazhdimisht të kujdesen dhe vlerësojnë efikasitetin e shtrirjes së plotë të mundësive të rimëkëmbjes ose ndërprerjes së rregullt të punës. Sistemi i pagesave duhet të përgatisë planet e duhura për rikuperim ose ndërprerjen e punës në bazë të rezultateve të vlerësimit. Aty ku është e aplikueshme, sistemi i pagesave duhet gjithashtu të sigurojë informata për autoritetet kompetente të nevojshme për qëllimet planifikimit të zgjidhjes.	X		
	<b>Principi 4: Rreziku i kredisë</b>	<b>4 KK</b>	<b>0 KK</b>	<b>0 KK</b>
1	Sistemi i pagesave duhet të vendosi një korniz të shëndoshë për të menaxhuar ekspozimin e kredisë së tij ndaj pjesëmarrësve dhe rreziqet e kreditit që dalin nga proceset e pagesave, kliringut dhe shlyerjes së tij. Ekspozimi i kredisë mund të lindë nga ekspozimi momental dhe/ose ekspozimet e mundshme në të ardhmen.	X		

2	Sistemi i pagesave duhet të identifikojë burimet e rrezikut të kredisë, ti masi dhe ti monitorojë në mënyrë rutinore ekspozimet e kreditit si dhe të përdorë mjete të përshtatshme për menaxhimin e rrezikut për të kontrolluar këto rreziqe.	X		
3	Sistemi i pagesave duhet të mbulojë ekspozimet e tij aktuale dhe atje ku egzistojnë, ekspozimet potenciale të ardhshme për secilin pjesëmarrës, në tërësi me një shkallë të lartë besimi, duke përdorur sigurim dhe burime të tjera ekuivalente financiare. Në rastin kur ka një sistem pagese me neto-shlyerje të shtyrë ku ska garancion të shlyerjes, por ku pjesëmarrësit e tij përballen me ekspozimet e kreditit që rrjedhin nga proceset e tyre të pagesave, proceset e kliringut dhe shlyerjes, sistemi i tillë i pagesave duhet të mbajë, në së paku, burime të mjaftueshme për të mbuluar ekspozimin ndaj dy pjesëmarrësve dhe bashkëpunëtorëve të tyre me ekspozimin më të madh total të kredisë në sistem.	X		
7	Sistemi i pagesave duhet të vendosë rregulla dhe procedura të qarta të cilat plotësisht merren me çfarëdo humbjesh nga kreditë që mund të ndodhë si rezultat i ndonjë pamundësisë të vetme ose të kombinuara për të shlyer detyrimet ndërmjet pjesëmarrësve në sistemin e pagesave. Me këto rregulla dhe procedura duhet të theksohet se si do të shpërndahen humbjet e mundshme të kreditit të cilat janë të pambuluara, duke përfshirë edhe pagesën e çfarëdo lloji të fondeve të cilat sistemi i pagesave mund të marrë hua nga ofruesit e likuiditetit. Këto rregulla dhe procedura gjithashtu duhet të tregojnë procesin e sistemit të pagesave për të plotësuar burimet financiare që janë përdorur prej tij, gjatë një ngjarjeje stresi, kështu që sistemi i pagesave mund të vazhdojë të operojë në mënyrë të sigurt dhe të pranueshme.	X		
<b>Principi 5: Siguria</b>		<b>6 KK</b>	<b>0 KK</b>	<b>0 KK</b>
1	Sistemi i pagesave kryesisht duhet të kufizojë fondet të cilat ai (në mënyrë rutinore) i pranon si kolateral për ata me rrezik të ulët kredisë, likuiditetit dhe tregut.	X		
2	Sistemi i pagesave duhet të vendosi praktika të kujdesshme për vlerësim dhe të zhvillojë koeficientë të mbulimit të cilat rregullisht testohen dhe të marrin parasysh kushtet e stresit të tregut.	X		
3	Me qëllim që të zvogëlohet nevoja për rregullime pro-ciklike të cilat rezultojnë nga një ndryshim në vlerën e asetëve, sistemi i pagesave duhet të vendosi koeficientë të qëndrueshëm dhe të rreptë të mbulimit të kalibruar në mënyrë të që të përfshijë periudhat e kushteve stresuese të tregut deri në shkallën e praktikitetit dhe kujdesit.	X		



4	Sistemi i pagesave duhet të shmangë përqendrimin në mbajtjen e asetëve të caktuara të cilat dëmtojnë ndjeshëm aftësinë për të likuiduar me shpejtësi asetet e tilla pa efekte të rëndësishme negative të çmimeve.	X		
5	Sistemi i pagesave i cili pranon siguri ndërkufitare duhet të zbusë rreziqet që lidhen me përdorimin e tij dhe të sigurojë që siguria mund të përdoret në kohën e duhur.	X		
6	Sistemi i pagesave duhet të përdorë një sistem për menaxhimin e sigurisë që është mirë i vendosur dhe operativisht fleksibël.	X		
<b>Principi 7: Rreziku i likuiditetit</b>		<b>9 KK</b>	<b>1 KK</b>	<b>0 KK</b>
1	Sistemi i pagesave duhet të ketë një kornizë të qëndrueshme për menaxhimin e rreziqeve të likuiditetit që vijnë nga pjesëmarrësit, bankat e shlyerjes, nostro-agjentët, bankat kujdestare të pronës, ofruesit e likuiditetit dhe subjektet e tjera.	X		
2	Sistemi i pagesave duhet të ketë mjete efektive operative dhe analitike për të përcaktuar, matur dhe monitoruar rrjedhjen e shlyerjes dhe rrjedhjen e mjeteve monetare në baza të rregullta dhe në kohë, duke përfshirë përdorimin e likuiditetit brenda ditës.	X		
3	Sistemi i pagesave, duke përfshirë një sistem që përdor një mekanizëm të neto-shlyerjes së vonuar, duhet të mbajë burime të mjaftueshme likuide në të gjitha valutat përkatëse për të përfunduar shlyerjen e detyrimeve të pagesave në të njëjtën ditë dhe, kur është e përshtatshme, shlyerje brenda ditës dhe shumëditore me një shkallë të lartë të besimit në një shtrirje të gjerë të skenarëve të mundshëm të stresit që duhet të përfshijë (por jo të kufizohet) pamundësia për të shlyer detyrimet e pjesëmarrësit dhe bashkëpunëtorëve të tij që do të krijonin detyrimin më të madh të likuiditetit për sistemin e pagesave në kushtet ekstreme por të mundshme të tregut.	X	X*	
5	Me qëllim që të plotësohen kërkesat minimale për likuiditet, sistemi i pagesave mund të përdorë mjete likuide në vijim në çdo valutë: paratë e gatshme në bankën qendrore të emetimit dhe bankat komerciale të ranguar mirë, linjat e kreditit të dakorduara, këmbime valutore (svop) të dakorduara dhe transaksione repo, siguria e madhe e tregut e ruajtur te kujdestari i pronës, si dhe investimet që janë lehtësisht të arritshme dhe janë të konvertueshme në para të gatshme me marrëveshjet financiare të paracaktuara dhe shumë të besueshme, në kushte të ndryshme ekstreme, por të mundshme të tregut. Nëse sistemi i pagesave ka qasje të rregullt në kredinë nga banka qendrore, ai mund të konsiderojnë këtë qasje si pjesë e kërkesave minimale për likuiditet deri në atë masë që ka kolateral adekuat që është e pranueshme	X		

\* Në pajtim me pikën 3 paragrafi 4 të këtij vendimi.

	për të premtuar tek (ose të kryejnë forma të tjera të përshtatshme të transaksioneve me) bankën qendrore përkatëse. Të gjitha këto mjete duhet të jenë të disponueshme kur të jetë e nevojshme.			
6	Sistemi i pagesave mund të plotësojë aktivet e tij likuide të pranueshme me forma të tjera të asetëve likuide. Nëse sistemi i pagesave e bën këtë, atëherë këto mjete likuide duhet të jenë në një formë e cila, në rast të pamundësisë për të shlyer detyrimet e pjesëmarrësit, mund të shiten lehtësisht ose të pranohen si kolateral për linjat e kredisë, këmbime (svope) ose repo në baza ad hoc, edhe nëse ajo nuk mund të negociohet paraprakisht ose të garantohet në kushte ekstreme të tregut. Edhe nëse sistemi i pagesave nuk ka qasje në një kredi rutinore nga banka qendrore, është ende e nevojshme të merret parasysh se çfarë sigurie zakonisht pranohet nga banka qendrore përkatëse, pasi ka më shumë gjasa që asetet e tilla të jenë likuide në rrethana stresuese. Sistemi i pagesave nuk duhet të konsiderojë disponueshmërinë e një kredie në instance të fundit të bankës qendrore si pjesë e planit të tij të likuiditetit.	X		
7	Sistemi i pagesave duhet të marrë shkallë të lartë besimi, nëpërmjet vlerësimeve strikte, që secili ofrues i mjeteve minimale likuide të nevojshme, qoftë ai pjesëmarrës në sistemin e pagesave ose një subjekt i jashtëm, ka informacion të mjaftueshëm për të kuptuar dhe menaxhuar rreziqet e lidhura të likuiditetit dhe se ka kapacitet për të përmbushur detyrimet e tij sipas kërkesës. Aty ku është e rëndësishme të bëhet një vlerësim i sigurisë së ofruesit të likuiditetit në lidhje me një valutë të caktuar, mund të merret parasysh potenciali i ofruesit të likuiditetit për qasje në kredi nga banka qendrore mund të merret parasysh. Sistemi i pagesave duhet të testojë rregullisht procedurat e tij për qasje në mjetet e tij likuide të ofruesit të likuiditetit.	X		
8	Sistemi i pagesave me qasje në llogaritë e bankave qendrore, shërbimet e pagesave ose shërbimet me letra me vlerë duhet të përdorë këto shërbime, aty ku është praktikisht e mundur, për të përmirësuar menaxhimin e rrezikut të likuiditetit.	X		
9	Sistemi i pagesave duhet të përcaktojë shumën e nevojshme të asetëve likuide dhe të testojë rregullisht nëse kjo shumë është e mjaftueshme përmes stress-testimit rigoroz. Sistemi i pagesave duhet të ketë procedura të qarta të raportimit për rezultatet e stress-testeve tek vendimmarrësit e duhur të sistemit të pagesave për të përdorur këto rezultate për të vlerësuar përshtatshmërinë dhe për të përshtatur kornizën e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit. Në kryerjen e stres-testimit, sistemi i pagesave duhet të përcaktojë një shtrirje të gjerë të skenarëve të përshtatshëm. Skenarët duhet të përfshijnë ndryshimet	X		

	<p>më të mëdha në çmimet në të kaluarën, ndryshimet tek faktorët e tjerë të tregut, të tilla si përcaktuesit e çmimeve dhe kurbat e rendimentit, falimentime të shumta gjatë periudhave të ndryshme kohore, presione të njëkohshme në treg të mjeteve dhe sigurimit të financimit, si dhe një përzgjedhje e madhe e skenarëve të orientuar drejt së ardhmes për kushte të ndryshme ekstreme, por të mundshme të tregut. Në skenarët gjithashtu duhet të marren në konsideratë pozicionimi dhe funksionimin e sistemit të pagesave, duke përfshirë të gjitha subjektet të cilat mund të shkaktojnë rreziqe materiale dhe të likuiditetit për sistemin e pagesave (si bankat e shlyerjes, nostro-agentët, bankat kujdestar të pronës, ofrues likuiditeti dhe sistemeve të tjera të lidhura me pagesat), dhe ku është e përshtatshme të mbulohet një periudhë shumë-ditore. Në të gjitha rastet, sistemi i pagesave duhet të ketë aranzhime adekuate të menaxhimit në lidhje me shumën dhe formën e totalit të aktiveve likuide që mban, si dhe të dokumentojë arsyetimin për këtë shumë.</p>			
10	<p>Sistemi i pagesave duhet të vendosi rregulla dhe procedura të qarta të cilat i mundësojnë qetë kryej punë në të njëjtën ditë dhe, sipas rastit, shlyerje brenda ditës dhe disaditor të detyrimeve të pagesave në kohë, pas paafësisë individuale ose të kombinuar për të shlyer detyrimet midis pjesëmarrësve. Këto rregulla dhe procedura duhet të theksojnë mangësitë e paparashikuara dhe mangësitë potencialisht të pambuluara të likuiditetit dhe duhet të përpiqen të shmangin lëshimin, heqjen ose vonimin e shlyerjes së detyrimeve të pagesave në të njëjtën ditë. Këto rregulla dhe procedura duhet gjithashtu të tregojnë procesin e sistemit të pagesave për rimbushjen e burimeve të likuiditetit që mund të përdorë gjatë një ngjarjeje stresuese në mënyrë që të vazhdojë të operojë në një mënyrë të sigurt dhe të shëndetshme.</p>	X		
	<b>Principi 8: Përfundim i shlyerjes</b>	<b>3 KK</b>	<b>2 KK</b>	<b>2 KK</b>
1	Rregullat dhe procedurat e sistemit të pagesave duhet të përcaktojnë qartë momentin në të cilin shlyerja është përfunduar.	X	X	X
2	Sistemi i pagesave duhet të përfundojë shlyerjen përfundimtare jo më vonë se fundi i datës së valutës, mundësisht gjatë ditës ose në kohë reale, në mënyrë që të zvogëlohet rreziku i shlyerjes. Sistemet e pagesave për pagesa të mëdha duhet të shqyrtojnë dhe të miratojnë një sistem në kohë reale dhe në baza bruto (RTGS) ose përpunim me shumë cikleve gjatë ditës së shlyerjes.	X		
3	Sistemi i pagesave duhet të përcaktojë qartë momentin sipas të cilit pagesat e pashlyera, udhëzimet	X	X	X

	për transferim ose detyrime të tjera nuk mund të tërhiqen nga pjesëmarrësi.			
	<b>Principi 9: Shlyerje me para të gatshme</b>	<b>5 KK</b>	<b>5 KK</b>	<b>0 KK</b>
1	Sistemi i pagesave duhet të kryejë shlyerjen e saj të parave të gatshme me fondet tek bankës qendrore, ku është praktike dhe e mundur, me qëllim shmangien e rreziqeve të kreditit dhe likuiditetit.	X	X	
2	Nëse fondet nuk përdoren në bankë qendrore, sistemi i pagesave duhet të kryejë shlyerjen e parave të gatshme duke përdorur mjete për shlyerje me rrezik të vogël ose pa rrezik të kredisë dhe likuiditetit.	X	X	
3	Nëse sistemi i pagesave shlyen me para të gatshme në bankat komerciale, atëherë duhet të monitorojë, menaxhojë dhe kufizojë rreziqet e tij të kreditit dhe të likuiditetit që rrjedhin nga bankat komerciale për shlyerje. Më sakt, sistemi i pagesave duhet të vendosi dhe monitorojë respektimin e kritereve strikte për bankat e tij për shlyerje, të cilat, ndër të tjera, marrin parasysh rregullimin dhe mbikëqyrjen e tyre, aftësinë kreditore, kapitalizimin, qasjen në likuiditet dhe sigurinë operationale. Sistemi i pagesave duhet të monitorojë dhe menaxhojë përqendrimin e ekspozimit të kredisë dhe të likuiditetit ndaj bankat komerciale për shlyerje.	X	X	
4	Nëse sistemi i pagesave zbaton shlyerjen e parave të gatshme në raportet për kontabilitet të tij, atëherë duhet të minimizojë dhe të kontrollojë rreptësisht rreziqet e tij të kreditit dhe të likuiditetit.	X	X	
5	Marrëveshjet e sistemit të pagesave me bankat e shlyerjes duhet të përmbajnë qartë një dispozitë që kur pritet transferimi në raportet për kontabilitet e bankave individuale të shlyerjes, ato duhet të jenë përfundimtare kur ato të ekzekutohen dhe fondet e marra duhet të jenë të transferueshme sa më shpejt të jetë e mundur, të paktën deri në fund të ditës dhe idealisht gjatë ditës, në mënyrë që ti mundësojnë sistemit të pagesave dhe pjesëmarrësit të tij për të menaxhuar rreziqet e kredisë dhe të likuiditetit.	X	X	
	<b>Principi 12: Sistemet e shlyerjes që përfshijnë shkëmbimin e vlerave</b>	<b>1 KK</b>	<b>0 KK</b>	<b>0 KK</b>
1	Sistemi i pagesave i cili është sistem për shlyerje që përfshin shkëmbimin e vlerave duhet të eliminojë rrezikun e kapitalit duke siguruar që shlyerja përfundimtare e një detyrimi të ndodhë nëse dhe vetëm nëse ndodh edhe shlyerja përfundimtare e një detyrimi të lidhur, pavarësisht nëse sistemi i pagesave është në baza bruto ose neto, dhe kur përfundimi ndodh.	X		
	<b>Principi 13: Rregullat dhe procedurat në rast të pamundësi për shlyerje të detyrimeve të pjesëmarrësit</b>	<b>4 KK</b>	<b>3 KK</b>	<b>2 KK</b>

1	Sistemi i pagesave duhet të ketë rregulla dhe procedura në rast të pamundësisë për të shlyer detyrimet e pjesëmarrësit, gjë që do t'i mundësojë atij të vazhdojë të përmbushi detyrimet dhe kompensimin e fondeve nëse një rast i tillë do të ndodhi.	X	X	X
2	Sistemi i pagesave duhet të jetë i përgatitur mirë për të zbatuar rregullat dhe procedurat në rast të pamundësisë për përmbushje të detyrimeve të pjesëmarrësit, duke përfshirë të gjitha procedurat e përshtatshme diskrecionale të parashikuara nga rregullat e tij.	X	X	X
3	Sistemi i pagesave duhet të zbulojë publikisht aspektet kryesore të rregullave dhe procedurave të saj në rast të pamundësisë për të përmbushur detyrimet e pjesëmarrësit.	X	X	
4	Sistemi i pagesave duhet të përfshijë pjesëmarrësit e tije dhe palë të tjera të interesuara në testimin dhe kontrollimin të procedurave në rast të pamundësisë për të përmbushur detyrimet e pjesëmarrësit, përfshirë edhe procedurat në rast të likuidimit. Testimet dhe kontrollet e këtilla duhet të kryhen të paktën një herë në vit ose pas ndryshimeve të rregullave dhe procedurave, për të siguruar që ato janë praktike dhe efektive.	X		
	<b>Principi 15: Rreziku i përgjithshëm i biznesit</b>	<b>5 KK</b>	<b>5 KK</b>	<b>0 KK</b>
1	Sistemi i pagesave duhet të ketë sisteme të fuqishme të menaxhimit dhe kontrollit për të identifikimin, monitorimin dhe menaxhimin e rreziqeve e përgjithshme të biznesit, duke përfshirë humbjet nga performanca e dobët e strategjisë së biznesit, dalja e parave të gatshme ose shpenzimet të tepërta dhe të mëdha operative.	X	X	
2	Sistemi i pagesave duhet të ketë neto-mjete likuide që vijnë nga kapitali (siç janë aksionet e zakonshme, rezervat e shpalosura ose fitime të tjera të pashpërndara) në mënyrë që të mund të vazhdojë të operojë dhe ofrojë shërbime si në kushte normale, edhe pse është i ekspozuar ndaj humbjeve në punë të përgjithshme. Shuma neto-mjeteve likuide që rrjedhin nga kapitali që duhet ti mbajë subjekti, duhet të përcaktohet nga profili i rrezikut të biznesit ndaj të cilit ai është i ekspozuar dhe nga kohëzgjatja që duhet për të arritur një rikuperim ose ndalim të rregullt në punën e operacioneve dhe shërbimeve të saj kritike, nëse një veprim i tillë merret si përkatse.	X	X	
3	Sistemi i pagesave duhet të mbajë një plan për një rikuperim të qëndrueshëm ose ndërprerje të rregulluar të punës dhe duhet të mbajë neto-mjete të mjaftueshme likuide që rrjedhin nga kapitali për zbatimin e këtij plani. Në minimum, sistemi i pagesave duhet të ruaj neto-mjete të mjaftueshme likuide të cilat e kanë origjinën nga kapitali, shuma e të cilave nuk është më pak se shpenzimet operative aktuale	X	X	

	gjashtëmujore. Këto fonde janë si plotsim i burimeve të ruajtura për të mbuluar pamundësinë për të shlyer detyrimet e pjesëmarrësit ose për të mbuluar rreziqet tjera në përputhje me parimet për burimeve financiare. Kapitali i cili ruhet në përputhje me standardet ndërkombëtare të kapitalit të bazuar në rizik mund të përfshihet aty ku është e rëndësishme dhe e përshtatshme për të shmangur dublikimin e kërkesave për kapital.			
4	Fondet të cilat i mban sistemi i pagesave për mbulimin e rrezikut të përgjithshëm të biznesit duhet të jenë të kualitetit të lartë dhe mjaftueshëm likuid në mënyrë që sistemit të pagesave ti mundsohet realizimi i kostove operacionale të tanishme dhe të parashikuara në disa skenarë, përfshirë këtu edhe kushtet e pafavorshme të tregut.	X	X	
5	Sistemi i pagesave duhet të mbajë një plan të zbatueshëm për rritjen e kapitalit për rastet kur kapitali i tij zvogëlohet në nivel ose nën nivelin e sasisë së nevojshme. Ky plan duhet të miratohet nga bordi i drejtorëve dhe të përditësohet rregullisht.	X	X	
	<b>Principi 16: Rreziku i kujdestarit të pronës dhe rreziku i investimeve</b>	<b>4 KK</b>	<b>0 KK</b>	<b>0 KK</b>
1	Sistemi i pagesave duhet të mbajë mjetet e tij dhe të pjesëmarrësve të tij në subjektet të cilat i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe rregullativës dhe që kanë praktika të shëndosha të kontabilitetit, procedura mbrojtjeje dhe kontrole të brendshme të cilat i mbrojnë plotësisht këto mjete.	X		
2	Sistemi i pagesave duhet të ketë qasje të shpejtë në mjetet e tij dhe mjetet e sigururara nga ana e pjesëmarrësve, sa herë që të jetë e nevojshme.	X		
3	Sistemi i pagesave duhet të vlerësojë dhe të kuptojë ekspozimin e tij ndaj bankave të tij – kujdestar të pronës, duke marrë parasysh shtrirjen e plotë të marrëdhënieve të tij me ato.	X		
4	Strategjia e investimit të sistemit të pagesave duhet të jetë në përputhje me strategjinë e saj të përgjithshme për menaxhimin e rreziqeve dhe të jetë plotësisht e shpalosur për pjesëmarrësit e saj, dhe investimet duhet të sigurohen nga ose të jenë kërkesa nga huamarrës me cilësi të lartë. Këto investime duhet të mundësojnë likuidim të shpejtë me një efekt të ulët të mundshëm negativ mbi çmimin.	X		
	<b>Principi 17: Rreziku operacional</b>	<b>7 KK</b>	<b>3 KK</b>	<b>3 KK</b>
1	Sistemi i pagesave duhet të krijojë një korniz të fortë për menaxhimin e rrezikut operacional me sisteme adekuate, politika, procedura dhe kontrole të duhura për të identifikuar, monitoruar dhe menaxhuar rreziqet operacionale.	X	X	X

2	Bordi i drejtorëve të sistemit të pagesave duhet qartë t'i përcaktojë rolet dhe përgjegjësitë për trajtimin e rrezikut operacional dhe duhet të miratojë kornizën për menaxhimin e rrezikut operacional të sistemit të pagesave. Sistemet, politikat operationale, procedurat dhe kontrollet duhet të rishikohen, t'i nënshtrohen auditimit dhe të testohen periodikisht dhe pas ndryshimeve të rëndësishme.	X		
3	Sistemi i pagesave duhet të ketë qëllime të përcaktuara qartë për besueshmërinë operationale dhe duhet të ketë politika të miratuara për të arritur këto qëllime.	X	X	X
4	Sistemi i pagesave duhet të sigurojë se ka një kapacitet përshtatshëm i duhur për trajtimin e vëllimit të shtuar të situatave stresuese dhe për arritjen e qëllimeve të përcaktuara për nivelin e shërbimeve.	X		
5	Sistemi i pagesave duhet të ketë vendosur politika gjithëpërfshirëse për sigurinë fizike dhe të informacionit që të merren me të gjitha dobësitë dhe kërcënimet potencial.	X	X	X
6	Sistemi i pagesave duhet të ketë një plan të vazhdimësisë së punës i cili mund të merret me ngjarjet të cilat paraqesin një rrezik të konsiderueshëm të çrregullimit të punës, duke përfshirë ngjarjet që mund të shkaktojnë një çrregullim të gjerë ose një katastrofa të madha. Plani duhet të mbulojë përdorimin e një lokacioni të largët dhe duhet të sigurojë mundësinë për të rikthyer në funksion sistemet kritike të teknologjia e informacionit deri në dy orë pas çrregullimit. Plani duhet të lejojë sistemin e pagesave të përfundojë shlyerjen deri në fund të ditës së çrregullimit, madje edhe në rast të rrethanave ekstreme. Sistemi i pagesave duhet të testojë rregullisht këto marrëveshje.	X		
7	Sistemi i pagesave duhet të identifikojë, monitorojë dhe menaxhojë rreziqet të cilat pjesëmarrsit kryesorë, sistemet e tjera të pagesave, sistemet e shlyerjes së letrave me vlerë dhe ofruesit e shërbimeve mund të ja transferojnë operationeve të tij. Gjithashtu, sistemi i pagesave duhet të identifikojë, monitorojë dhe menaxhojë rreziqet të cilat nga operationet e tij mund të transferohen në operationet e sistemeve të tjera të pagesave dhe sistemeve të shlyerjes së letrave me vlerë.	X		
	<b>Principi 18: Kërkesat për qasje dhe pjesëmarrje</b>	<b>3 KK</b>	<b>3 KK</b>	<b>2 KK</b>
1	Sistemi i pagesave duhet të sigurojë qasje të drejtë dhe të hapur në shërbimet e tij për pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë dhe kur është e nevojshme, të tërthortë dhe sistemet e tjera të pagesave, bazuar në kërkesat e arsyeshme për pjesëmarrje të cilat janë të bazuara në rrezik.	X	X	X
2	Kërkesat për pjesëmarrje në sistemin e pagesave duhet të justifikohen në aspektin e sigurisë dhe	X	X	

	efikasitetit të subjektit dhe të tregjeve në të cilat ai shërben dhe janë të udhëzuar dhe të proporcionalizuara me rreziqet specifike të sistemit të pagesave dhe të shpallen publikisht. Sistemi i pagesave duhet të mbajë standarde të pranueshme të kontrollit të rrezikut dhe duhet të vendosë kërkesa të cilat kanë më së paku ndikim kufizues ndaj qasjes së lejuar nga rrethanat.			
3	Sistemi i pagesave duhet të monitorojë përputhjen me kërkesat e tij për pjesëmarrje në baza të rregullta dhe duhet të ketë procedura të qartë dhe publikisht të shpallura për pezullim dhe dalje të rregullt të një pjesëmarrësi i cili ka shkelur ose nuk i plotëson më kërkesat për pjesëmarrje.	X	X	X
	<b>Principi 19: Marrëveshjet e pjesëmarrjes me shumë nivele</b>	<b>4 KK</b>	<b>0 KK</b>	<b>0 KK</b>
1	Sistemi i pagesave duhet të sigurojë se rregullat, procedurat dhe marrëveshjet e tij mundësojnë grumbullimin e informacioneve bazë për pjesëmarrësit indirekt me synimin për të identifikuar, monitoruar dhe menaxhuar çdo rrezik material për të cilin sistemi i pagesave është i ekspozuar, dhe i cili rrjedh nga marrëveshjet për pjesëmarrje me shumë nivele.	X		
2	Sistemi i pagesave duhet të përcaktojë varësinë materiale midis pjesëmarrësve të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë e cila mund të ndikojnë në sistemin e pagesave.	X		
3	Sistemi i pagesave duhet të përcaktojë pjesëmarrësit e tërthortë përgjegjës për një pjesë të konsiderueshme të transaksioneve të procesuara të sistemit të pagesave dhe pjesëmarrësve të tërthortë, numri ose vlera e transaksioneve të të cilëve janë relativisht të mëdha për kapacitetin e pjesëmarrësit të drejtpërdrejtë nëpërmjet të cilit ata hyjnë në sistemin e pagesave me qëllim të menaxhimit të rreziqeve që dalin nga këto transaksione.	X		
4	Sistemi i pagesave duhet të rishikojë rregullisht rreziqet që dalin nga marrëveshjet për pjesëmarrje me shumë shtresa dhe duhet të ndër marrë aktivitete zbutëse kur ka kërkesa të përshtatshme.	X		
	<b>Principi 21: Efikasiteti dhe efektiviteti</b>	<b>3 KK</b>	<b>1 KK</b>	<b>1 KK</b>
1	Pozicionimi i sistemit të pagesave duhet të plotësojë nevojat e pjesëmarrësve të tij dhe tregjeve në të cilat operon, por në veçanti në lidhje me përzgjedhjen e marrëveshjes të kliringut dhe shlyerjes; struktura operacionale; vija e produkteve të cilat janë të netuara, shlyen ose regjistrohen dhe në lidhje me përdorimin e teknologjisë dhe procedurave.	X	X	X
2	Sistemi i pagesave duhet të ketë qëllime dhe objektiva të përcaktuara qartë që janë të matshëm dhe të realizueshëm, si në zonat me një nivel shërbimi minimal, pritjet e menaxhimit të rrezikut dhe prioritetet e punës.	X		



3	Sistemi i pagesave duhet të ketë vendosur mekanizma për të rishikuar rregullisht efiikasitetin dhe efektivitetin e saj.	X		
	<b>Principi 22: Procedurat dhe standardet e komunikimit</b>	<b>1 KK</b>	<b>1 KK</b>	<b>0 KK</b>
1	Sistemi i pagesave duhet të përdorë ose të paktën të përshtatet me procedurat dhe standardet e komunikimit të pranuar ndërkombëtarisht.	X	X	
	<b>Principi 23: Shpalosja e rregullave, procedurave kryesore dhe të dhënave të tregut</b>	<b>5 KK</b>	<b>3 KK</b>	<b>3 KK</b>
1	Sistemi i pagesave duhet të miratojë rregulla dhe procedura të qarta dhe gjithëpërfshirëse të cilat u janë shpalosur plotësisht pjesëmarrësve. Rregullat përkatëse dhe procedurat kryesore duhet gjithashtu të shpalosen publikisht.	X	X	X
2	Sistemi i pagesave duhet të japë përshkrime të qarta për pozicionimin dhe operacionet e sistemit, si dhe për të drejtat dhe detyrimet e sistemit të pagesave dhe pjesëmarrësve, në mënyrë që pjesëmarrësit të mund të vlerësojnë rreziqet ndaj të cilave do të ekspozohen me pjesëmarrjen në sistemin e pagesave.	X	X	X
3	Sistemi i pagesave duhet të sigurojë dokumentacionin e nevojshëm dhe trajnimin e nevojshëm për të mundësuar kuptimin e rregullave dhe procedurave të sistemit të pagesave për pjesëmarrësit dhe rreziqet me të cilat ballafaqohen nga pjesëmarrja në sistemin e pagesave.	X		
4	Sistemi i pagesave duhet të zbulojë publikisht tarifat e tij në nivelin e shërbimeve individuale që ofron, si dhe politikën e tij për të gjitha zbritjet në dispozicion. Sistemi i pagesave duhet të japë një përshkrim të qartë të shërbimeve që i paguan për qëllime krahasuese.	X	X	X
5	Sistemi i pagesave duhet rregullisht të kompletoj dhe të zbulojë përgjigjet e Kornizës për shpallje të infrastrukturës të tregjeve financiare të Komisionit për sistemet e pagesave dhe të shlyerjes në Bankën për shlyerje ndërkombëtare dhe në Bordin e organizatës ndërkombëtare të komisioneve të letrave me vlerë. Sistemi i pagesave duhet të paktën të japë informacione themelore mbi numrin dhe vlerën e transaksioneve.	X		

6. Për sistemin e pagesave që menaxhohet dhe/ose është në pronësi të Bankës Popullore, gjatë vlerësimit e përputhshmërisë me kërkesat kryesore 3 dhe 4 të principit 2, kërkesa kryesore 4 e principit 3 dhe kërkesa kryesore 2, 3, 4 dhe 5 të principit 15, merren parasysh aspektet ligjore të rolit institucional dhe statusin e Bankës Popullore.

Banka Kombëtare nuk kufizohet në definimin dhe zbatimin e politikave të saj në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore gjatë zbatimit të principeve lidhur me:

- sigurimi i kredisë ose përcaktimi i kushteve dhe kufizimeve për të siguruar kredisë (principi 4);
- pranimin e asaj që është e përshtatshme si kolateral gjatë operacioneve të saj të kredisë (principi 5);
- ruajtja e stabilitetit financiar, duke përfshirë marrjen me pamundësin për të shlyer detyrimet nga ana e bankave (principi 13);
- strategjia e saj e investimit (përfshirë strategjinë e administrimit të rezervës valutore) ose shpалosja e strategjisë (principi 16);
- e drejta e saj për të përcaktuar se kujt dhe në çfarë kushtesh mund të hapë një llogari (principi 18), ose
- zgjedhja e saj gjatë zbatimit e politikës monetare.

7. Sistemet e pagesave janë të detyruara të harmonizojnë veprimet e tyre me standardet brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

8. Në datën e zbatimit të këtij vendimi pushon së qeni në fuqi Vendimi mbi kriteret dhe standardet për funksionimin e sistemeve të pagesave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 159/07).

9. Ky vendim hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", dhe zbatohet pas skadimit të 18 muajve nga dita e hyrjes në fuqi.

**V Nr.02-15 / I-7/2016**  
**28 janar 2016**  
**Shkup**

**Guvernatori dhe Kryetar Këshilli i Bankës  
 Popullore të Republikës së Maqedonisë  
 Dimitar Bogov**